

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, me gjyqtarin individual Ilir Bytyqi dhe sekretaren juridike Mimoza Shabani, në çështjen penale kundër të pandehurit B.M., për shkak të veprës penale të rrezikimit të trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par. 6 dhe 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.70-6/15 të dt. 05.11.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik në praninë e përfaqësuesit të akuzës – Prokurorit të Shtetit Ismet Rrahmani, Përf. me autorizim i palës së dëmtuar F.A., av. A.D. dhe të pandehurit B.M., me datë 22 Prill 2016 mori dhe publikisht komunikoi, kurse me dt. 29 Prill 2016 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari: **B.M.**, data e lindjes.... në Kaqanik, nga i ati I. dhe nëna K. e gjinisë M. , me vendbanim në nga Fsh.K. Ferizaj, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfër ekonomike, me nr. personal

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datë 16.01.2015, rreth orës 13:10, në Fsh. Godancë i Epërm K. Shtime, në hyrje të fshatit përball shtëpisë së B.I. duke drejtuar automjetin transportues të markës ‘Mercedes’, ngjyrë të bardhë, me targa të regjistrimit, nga pakujdesia e në kundërshtim me nenin 54 pika 1 të LKSRR-së, ka rrezikuar trafikun publik dhe jetën e njerëzve, në atë mënyrë që nuk i ka përshtatur shpejtësisë së lëvizjes dhe kushteve të rrugës, pasi që rruga ishte e mbuluar me borë dhe akull, ashtu që humb kontrollin mbi drejtimin e automjetit dhe nga shiriti i tij qarkullues ka dal jashtë rrugë është goditur në bregun e rrugës në anën e djathtë dhe pastaj rrokulliset dhe në pjesën e majtë të automjetit e godet këmbësoren-të dëmtuarën F.A. e cila ishte duke lëvizur në trotuar në drejtimin e njëjtë, ku me këtë rast gjymtyrët e poshtme të trupit të saj mbesin nën kamion , ku në këtë aksident e dëmtuara

pëson lëndime të rënda trupore dhe atë: polytraume, thyerje në acetabulumin e djathtë, thyerje në anën e djathtë dhe të majtë të kombikut dhe dislokim në simfizën publike.

me të cilën ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 8 lidhur me par. 6 dhe 1 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të nenit 378 dhe neneve 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 45, 46, 47, 73 dhe 74 të KPRK-ës, dhe nenit 365 të KPP-ës, e

G J Y K O N

- **ME DENIM ME BURGIM NË KOHËZGJATJE PREJ 6 /gjashtë/ Muaj, i cili dënim konform nenit 47 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarit i zëvendësohet me dënim me gjobë në lartësi prej 400 /katërqind/ €, të cilin është i obliguar që ta paguaj ne afat prej 4 Muaj, në 4 këste nga 100 /njëqind/ € në Muaj, pasi që aktgjykimi e merr formën e prerë, nen kërcënim te ekzekutimit me dhunë.**
- **Ne rast se i pandehuri dështon ta paguaj me kohe njërin nga këste e sipërcekur, gjykata mundësin e kësteve do ta revokoj.**
- **Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara me nenin 46 par. 3 të KPRK-ës, i njëjti do të ekzekutohet në atë mënyrë që i akuzuari për çdo 20 €, do të vuaj një ditë burgimi.**
- **E dëmtuara F.A., për realizimin e kërkesës pasurore – juridike, udhëzohet ne kontest civil.**
- **Obligohet e akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 /njëzetë/ €, si dhe shpenzimet e procedurës penale (ekspertiza mjekoligjore dhe ekspertiza e komunikacionit) shumen prej**

60.88 /gjashtëdhjetë euro e tetëdhjetetë cent/ € në afatin prej 30 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj- Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën të evidentuar PP/II.nr.70-6/15 e dt.05.11.2015, ka ngarkuar të pandehurit B.M., për veprën penale te rrezikimit te trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së.

Gjykata pasi studioi materialet e çështjes penale te paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është ne juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet te realizohet përpara kësaj gjykate. Po kështu është ne kompetencën lëndore dhe territoriale te kësaj gjykate, pasi vepra penale për te cilën është proceduar te pandehurit gjykohet nga gjyqtari individual.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 22 Prill 2016, në të cilën shqyrtim fillestar: *i akuzuari është deklaruar fajtor për veprën për të cilën e ngarkon akuza, duke e shprehur pendimin për veprën penale të kryer, si dhe duke premtuar se nuk do të përsërisë vepra të kësaj natyre.*

Prokurori i Shtetit Ismet Rrahmani, duke shprehur mendimin e tij përkitazi me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të akuzuarit, duke i propozuar Gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtorë dhe të i shqipton dënim sipas ligjit.

Përf. me autorizim i të dëmtuarës F.A. Av. A.D., pas konsultimit me familjen e të dëmtuarës në seancën e shqyrtimit fillestar ka deklaruar se nuk i bashkëngjitëm ndjekjes penale kurse kërkesën pasurore juridike do ta parashtrrojë në procedurë kontestimore.

Pasi që e akuzuara ka pranuar fajësinë që në fillim të shqyrtimit fillestar, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit,

shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 1 të KPPK-së, dhe me këtë rast vlerësoi se.

- i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit;
- pranimi është bërë vullnetarisht;
- pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit përkatësisht mbrojtja e të akuzuarit gjatë procedurës hetimore dhe në shqyrtimin fillestar, raporti i aksidentit 2015-CFT-..... dt. 16.01.2015, ekspertiza e komunikacionit dt. 04.06.2015, ekspertiza mjeko-ligjore dt. 14.06.2015, fletë lëshimi i QKUK-së në Prishtinë i dt.16-26.01.2015 si dhe fotografit të cilat gjenden në shkresat e lendes, të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore;
- si dhe akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Me qenë se i akuzuara ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjyqtari individual konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, *(nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësorë, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale të rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 8 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së, meqë me datë, vend dhe kohë siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi i pandehuri nga pakujdesia duke drejtuar automjetin e markës 'Mercedes', ngjyre të bardhë, ka rrezikuar trafikun publik dhe jetën e njerëzve, në atë mënyrë që nuk e ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes dhe kushteve në rrugë, pasi që rruga ishte e mbuluar më borë dhe akull, ashtu që humb kontrollin mbi drejtimin e automjetit dhe nga shiriti i tij qarkullues ka dal jashtë rruge është goditur në bregun e anës së djathtë dhe pastaj rrokulliset dhe me pjesën e majtë të automjetit e godet këmbësoren- të dëmtuarën F.A., e cila ishte duke lëvizur në trotuar në drejtim të njëjtë ku në

këtë rast gjymtyrët e poshtme të trupit të saj mbesin nën kamion, ku në këtë aksident e dëmtuara pëson lëndime të rënda trupore dhe atë: polytraume, thyerje në acetabulumin e djathtë, thyerje në anën e djathtë dhe të majtë të kombikut dhe dislokim në simfizën pubike.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73,74 dhe 75 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se në të gjitha fazat e procedurës penale ka pranuar fajësinë, rrethana lehtësuese pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer e që këto rrethana i ndërlidhi me faktin se i pandehuri deri tani nuk ka qenë i dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë, është i moshës së re dhe i gjendjes së dobët ekonomike, në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë, duke marrë parasysh edhe faktin se akuzuari në të gjitha fazat e procedurës penale ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 41 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

E dëmtuara: F.A., për realizimin e kërkesës pasurore – juridike, udhëzohet në kontest civil.

Konform neneve 450 dhe 453 të KPPK-ës, obligohet e akuzuara që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 20/njëzetë/€ , si dhe shpenzimet e procedurës penale (ekspertiza mjekoligjore dhe ekspertiza e komunikacionit) shumen prej 60.88 /gjashtedhjet/ € në afatin prej 30 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë, bazuar në komplikueshmërinë e kësaj çështje dhe gjendjen ekonomike të të pandehurës.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

P.nr.1427/15, data 29.04.2016.

**Sekretare Juridike,
Mimoza Shabani**

**Gjyqtari Individual,
Iir BYTYQI**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.